



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy

Ministria e Ekonomisë në mbështetje të nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit Nr.05/L-084, për Rregullatorin e Energjisë, (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 25/14 Korrik 2016), për emërim të kandidatëve për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, shpallë:

KONKURS

për dy (2) pozita të Anëtarit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRrE)

Detyrat kryesore të Bordit të Rregullatorit:

Përveç përgjegjësi të përcaktuara me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Rregullatorit:

- miraton politikat rregullative dhe operacionale të Rregullatorit;
- organizon dhe mbikëqyrë punën e Rregullatorit;
- mbikëqyrë zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar të Rregullatorit dhe miraton raportet dhe deklaratat financiare të saj;
- organizon procedurat e rekrutimit dhe mbikëqyrë punën e personelit të punësuar nga Rregullatori;
- miraton nivelet e kompensimit dhe kushtet tjera të punësimit, për të punësuarit e Rregullatorit;
- harton dhe miraton Kodin e Etikës Profesionale për anëtarët dhe personelin e Rregullatorit;
- harton dhe miraton akte nënligjore që janë të nevojshme për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-084, për Rregullatorin e Energjisë;

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Kandidati për anëtar të Bordit duhet:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, me vendbanim të përhershëm në Kosovë;

- të ketë diplomë universitare në fushën teknike, të ekonomisë apo të drejtësisë nga një institucion i akredituar i arsimit të lartë;
- të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune në sektorin e energjisë;
- të mos ketë dosje të hapur të hetimeve apo dosje të mëhershme të dënimit për veprë penale apo të ushtrisë aktivitete që mund të vënë në dyshim sinqeritetin, integritetin apo kompetencën e tij;

KUSHTET

 Anëtarit të Bordit gjatë mandatit të tij në këtë pozitë nuk i lejohet:

1. Të jetë zyrtar qeveritar;
2. Të jetë pjesë e strukturave të një partie politike;
3. Të jetë vetë, ta ketë bashkëshortin/en apo ndonjë të afërm të familjes së ngushtë në cilësinë e aksionarit, partnerit, pronarit ose menaxherit në një ndërmarrje të energjisë që i nënshtrohet Ligjit Nr. 05/L-084, për Rregullatorin e Energjisë, apo në një ndërmarrje vartëse apo në një filial të një ndërmarrjeje të energjisë;
4. Të kryejë çfarëdo pune për ndonjë ndërmarrje të energjisë që i nënshtrohet Ligjit Nr.05/L-084, për Rregullatorin e Energjisë, apo për ndonjë ndërmarrje vartëse, apo për ndonjë filial të një ndërmarrjeje të energjisë;
5. Të mbajë një pozitë tjetër në kuadër të Rregullatorit;
6. Të kryejë një aktivitet tjetër që mund të rezultojë në konflikt interesi sipas Kodit të Etikës Profesionale të hartuar dhe të miratuar nga Rregullatori, apo sipas ligjeve përkatëse.

AFTËSITË PERSONALE TË KËRKUARA

- Udhëheqje
- Pune ekipore
- Bashkëpunim efektiv me palët e interesit;
- Të menduar strategjik
- Të jetë I/e orientuar ndaj rezultateve
- Vendim-marrje
- Aftësi ndikuese
- Koherencë të qartë dhe komunikim konciz
- Ndërgjegjshmëri
- Të menduar kreativ

Njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme dhe paraqet përparësi.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURRIMIT

Ministria e Ekonomisë ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga gratë dhe të gjitha komunitetet pakicë në Kosovë.

Ministria e Ekonomisë siguron që procedurat e përzgjedhjes të jenë të hapura, ofron konkurrencë jo-diskriminuese, objektive dhe transparente, duke u bazuar në një grup kualifikimesh dhe aftësish të përcaktuar më parë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e sektorit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Kandidatët për anëtar të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë duhet të dorëzojnë këto dokumente **(Dështimi për ta bërë këtë do të rezultojë në refuzimin e aplikacionit)**:

- Kërkesën për punësim që mund të shkarkohet në Web faqen <http://www.me.rks-gov.net>
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Listën Kontrolluese të plotësuar dhe nënshkruar duke deklaruar cilat prej kritereve themelore dhe të dëshirueshme aplikanti i plotëson. Kjo listë mund të shkarkohet duke përdorur linkun: <http://www.me.rks-gov.net>
- CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë.
- Letër motivimin duke ofruar një shpjegim të qartë se si përvoja dhe aftësitë e juaja (aplikantit) përputhen me kërkesat detyrës.
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional dhe përvojës së punës për të gjitha pozitat përkatëse)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se aplikuesi nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale
- Kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit.

Aplikuesi duhet të plotësojë personalisht deklaratën nën betim me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe të përshtatshmërisë profesionale. Deklarata nën betim mund të shkarkohet në Ueb faqen e ME-së.

Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur (të shkruhet emri dhe mbiemri si dhe titulli i pozitës në të cilën aplikon kandidati) dhe të dorëzohet në Ministrinë e Ekonomisë, zyra nr. 102 (Arkiva), Rruga "Nena Tereze", Nr.36, Prishtinë.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes Nr. Kontaktues: 038/20021524.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Afati i konkurrimit nga data 20.04.2021 deri më datë 19.05.2021, deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit.